

# Monitorimi i kostos së fushatës parazgjedhore

Zgjedhjet e përgjithshme  
për Kuvendin e Republikës  
së Kosovës 2010



Programi për transparencë dhe anti-korrupsion  
Transparenca në financimin e subjekteve politike

Mars 2011

**PERSONELI:**

Ismet KRYEZIU - *Drejtor Ekzekutiv*

Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*

Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*

Arsim GJINOVCI - *IT & design*

**PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI**

- Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*
- Enis XHEMAJLI- *Kryesues i hulumtimit*
- Yllka VESELI- *Hulumtuese*
- Esat MAZREKU - *Koordinator*

**PROGRAMI - DEMOKRATIZIMI DHE PRAKTIKAT PARLAMENTARE**

- Driton SELMANAJ - *Menaxher i programit*
- Isuf ZEJNA - *Vëzhgues i parlamentit*
- Besnik RAMADANAJ - *Vëzhgues i parlamentit*
- Natyra KASUMAJ- *Vëzhgues i parlamentit*

**PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE DHE PJESËMARRJA QYTETARE**

- Naim CAHANAJ - *Koordinator*
- Kreshnik BASHA - *Koordinator*

**PROGRAMI - ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA**

- Liridon SELMANI - *Menaxher i programit*

## Përmbajtja

# 4

I. Hyrje	5
A. Baza Ligjore	6
B. Historik i shkurtë mbi transparencën e subjekteve politike në publikimin e financave	8
Lëshimet më të shpeshta të subjekteve politike gjatë vitit 2009 sipas Raportit të Auditorit	10
Sjelljet e subjekteve politike në raport me transparencën e financimit të tyre gjatë fushatës parazgjedhore 2010	11
II. Rezultate dhe analiza e të dhënave	12
A. Metodologjia e hulumtimit	12
B. Rezultate të përgjithshme	13
C. Shpenzimet e subjekteve politike të deklaruara në KQZ deri më 22 mars 2011	14
Ç. Shpenzimet për aktivitete: takimet e qytetareve dhe reklamat në rrugë	16
1. Shpenzimet në ditë për aktivitete	17
2. Shpenzimet për komunë	18
D. Shpenzimet në shtypin ditor	20
1. Sipas subjektit	20
2. Sipas gazetës	22
3. Sipas subjektit dhe gazetës	23
Dh. Shpenzimet në ueb portale	24
1. Sipas subjektit	24
2. Sipas ueb portalit	25
3. Sipas subjektit dhe ueb portalit	26
E. Shpenzimet në televizione (TV) dhe radio	27
1. Sipas televizioneve (TV-ve)	28
2. Sipas subjekteve dhe televizioneve (TV-ve)	29
III. Përfundime dhe rekomandime	32
A. Përfundime	32
B. Rekomandime	33
IV. Referenca	34
V. Mirënjohje	35
IV. Shtojca	36
A. Lista e tabelave dhe grafikëve	36
B. Formulari	37

## 1. HYRJE

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) pjesë të aktiviteteve ka edhe realizimin e projektit CRINIS i cili ka për qëllim ndriçimin e parave në politikë. Koncepti i këtij projekti është zhvilluar nga organizata me renome botërore kundër korrupsionit Transparency International, duke u realizuar në shumë vende të botës, e së fundmi edhe në shtetet e Ballkanit Perëndimor: Kosovë, Shqipëri, Kroaci, Maqedoni, dhe Serbi.

Qëllimi i këtij projekti është të vlerësojë kornizën ligjore dhe zbatimin e këtyre ligjeve në aspektin e transparencës së financave në politikë. Bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi zhvillon aktivitete avokimi për bërë reforma me qëllim të përmirësimit të këtyre ligjeve dhe zbatimit të tyre.

Në kuadër të këtij projekti KDI ka monitoruar edhe kostot e subjekteve politike gjatë fushatës parazgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 12 dhjetor 2010, duke filluar nga 1 deri më 10 dhjetor 2010.

Me monitorim i referohemi vëzhgimit dhe dokumentimit sistematik dhe objektiv të një procesi të veçantë në një periudhë të dhënë kohore. Në aspektin e financave që subjektet politike përdorin gjatë fushatës zgjedhore, qëllimi kryesor i monitorimit është që të kontribuojë që në këtë ambient korrupsioni të jetë më pak i përhapur ose gjasat që të paraqitet të jenë më të vogla, duke promovuar reforma të mirëfillta të ligjit dhe zbatimit të këtij të fundit.

Organizata Open Society Institute, e cila ka bashkëpunuar me Transparency International (TI) në realizimin e të njëjtit projekt në Amerikën Latine, definojnë financimin e fushatave zgjedhore si “burimet e fituara dhe shpenzuara nga subjektet politike në fushata zgjedhore<sup>1</sup>”. KDI është fokusuar në të dytën: në monitorimin e kostove të subjekteve politike gjatë fushatës parazgjedhore. Duke qenë se publikut kosovar kurrë më parë nuk iu është shërbyer informata se sa shpenzojnë subjektet politike për fushatë parazgjedhore, KDI bëhet organizata e parë në Kosovë që e ndërmerr një hap të këtillë.

<sup>1</sup>Open Society Institute (2005): Monitoring Election Campaign Finance, A handbook for NGOs. Justice in Action Series. Central European University Press, f. 14.

## A. Baza ligjore

6

Financimi i subjekteve politike rregullohet me dy ligje: Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës<sup>2</sup>, dhe Ligjin për financimin e subjekteve politike<sup>3</sup>, si dhe me rregulla zgjedhore dhe vendime tjera të Komisionit Qendror Zgjedhor të Republikës së Kosovës<sup>5</sup>.

Në bazë të Nenit 7 të Ligjit për financimin e subjekteve politike “financimi publik i subjekteve politike bëhet përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike” që “funksionon në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”. Këto mjete ë “shfrytëzohen për financimin e aktiviteteve parazgjedhore e zgjedhore, financimin dhe punën e Grupeve Parlamentare dhe financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike” dhe që “nuk mund të kalojë (0.17 %) të Buxhetit të Kosovës”<sup>6</sup>. Duke pasur parasysh që Buxheti i rishikuar për vitin 2010 ishte 1,256,000,000 Euro<sup>7</sup>, 0.17 % i bie që ky fond për financimin e subjekteve politike për vitin 2010 ka pasur në dispozicion 2,135,200 Euro. Neni 9 i këtij ligji rregullon ndarjen e këtyre mjeteve në “mes të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në bazë të numrit të ulëseve për atë mandat”<sup>8</sup>.

“Për financimin e fushatës zgjedhore qendrore dhe lokale, për zgjedhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme, Kuvendi, nga Fondi, ndan mjete me propozim të Qeverisë por jo më shumë se 0.05 % të Buxhetit të Kosovës”<sup>9</sup>. Kjo do të thotë që, nga Fondi i lartpërmendur vetëm me qëllim të financimit të fushatave parazgjedhore ndahen 628,000 Euro, dhe atë 90 % i këtyre mjeteve financiare u ndahet subjekteve politike “në bazë të numrit të vendeve në Kuvend” nga zgjedhjet e fundit, dhe 10 % “ndahen proporcionalisht për subjektet politike të posa regjistruara dhe të certifikuara për zgjedhjet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”<sup>10</sup>.

Pra, duke u bazuar në Nenin 10, si më lartë, ne mund të vijmë në përfundim se subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend në bazë të rezultateve të Zgjedhjeve të Përgjithshme të vitit 2007, për këtë fushatë kanë marrë 565,200 Euro, dhe si në vijim:

<sup>2</sup> Ligji nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. DHE Ligji nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-073 i hyrë në fuqi më 29 tetor 2010.

<sup>3</sup> Ligji nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike.

<sup>4</sup> Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 64 dhe 128

<sup>5</sup> Vërejtje: Dispozitat ligjore e munguara në ligjet e reja janë mbuluar me UNMIK Rregulloren nr. 2004/11 mbi regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë e hyrë në fuqi më 5 maj 2004

<sup>6</sup> Ligji nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, Neni 7 Fondi për mbështetjen e subjekteve politike.

<sup>7</sup> Ligji nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, Neni 9 Ndarja e mjeteve financiare publike.

<sup>8</sup> Ligji nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, Neni 9 Ndarja e mjeteve financiare publike.

<sup>9</sup> Ligji nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, Neni 10 Ndarja e mjeteve financiare për fushatë zgjedhore.

<sup>10</sup> Ligji nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, Neni 10 Ndarja e mjeteve financiare për fushatë zgjedhore.



	Subjekti	Numri i deputetëve në mandatin e fundit	Vlera në Euro	Përqindja
1	PDK	37	174,270	30.83
2	LDK	25	117,750	20.83
3	AKR	13	61,230	10.83
4	AAK	13	61,230	10.83
5	LDD	11	51,810	9.17
6	SLS	8	37,680	6.67
7	7+	7	32,970	5.83
8	PDAK	3	14,130	2.5
9	SDSKIM	2	9,420	1.67
10	SNS	1	4,710	0.83
	<b>Shuma</b>	120	565,200	100

**Tabela 1.** Shumat e ndara nga Fondi për mbështetjen e fushatës zgjedhore të subjekteve politike sipas përfaqësimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës në mandatin e fundit (2007-2010).

Subjekteve politike të sapo regjistruara dhe të certifikuara për zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), i është ndarë proporcionalisht një shume prej 62,800 Euro, apo 10 % e mjeteve financiare të përgjithshme të ndara për financimin e fushatës së subjekteve politike.

Në anën tjetër, KQZ me Rregullën zgjedhore nr. 12/2009 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar ka kufizuar shpenzimet gjatë “fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës” në “pesëqind euro (500 €) për çdo një mijë (1000) votues të regjistruar”<sup>11</sup>, apo që ndryshe mund të shprehet 0.50 Euro për çdo votues të regjistruar.

Gjithashtu, duke u bazuar në vendimin e KQZ-së të datës 29 nëntor 2010 Vendim për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës më 12 dhjetor 2010, numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar është 1,630,636. Nga kjo mund të kuptojmë që secili subjekt politik që merr pjesë në Zgjedhjet e Përgjithshme në shtet për fushatën 10 ditore parazgjedhore nuk mund të ketë shpenzime më shumë së 815,318 Euro.

<sup>11</sup> KQZ Rregulla Zgjedhore nr. 12/2009 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, Neni 2 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe kontributet, Paragrafi 1.

## B. HISTORIK I SHKURTË MBI TRANSPARENCËN E SUBJEKTEVE POLITIKE NË PUBLIKIMIN E FINANCAVE

Që nga paslufta e deri më tani , subjektet politike asnjëherë nuk kanë pasur vullnet për të deklaruar raportet e tyre financiare, duke përfshirë të ardhurat, kontributet, burimet e financimit, pasuritë, detyrimet, kapitalin dhe shpenzimet.

Bazuar në informatat e marra nga KQZ del se edhe pse nga viti 2004 ka ekzistuar rregullorja e UNMIKUT 2004/11 e cila obligon subjektet politike që të dorëzojnë raportet e tyre financiare, ato gjithmonë kanë shkelur ligjin dhe se shumë shpesh kanë qenë subjekt i shqiptimit të gjobave nga ana e OSBE-së e më vonë edhe nga vetë KQZ-ja. Për më shumë, raporti i fundit i auditimit të deklaratave financiare të subjekteve politike për zgjedhjet lokale te vitit 2009<sup>12</sup>, nxjerr në pah disa fakte që tregojnë se subjektet politike ende vazhdojnë traditën e vjetër, duke neglizhuar kështu zbatimin e çfarëdo rregulle apo ligji e cila obligon ato që të deklarojnë raportet e tyre financiare. Në bazë të këtij raporti, elementet të cilat janë marrë për bazë dhe që kanë mundësuar verifikimin mbi plotësimin korrekt të deklaratave financiare të subjekteve politike janë:

- Nëse Subjekti politik mban evidencat adekuate mbi transaksionet financiare;
- Nëse deklaratat financiare janë raporte complete dhe me kohë;
- Nëse janë respektuar Ligjet dhe Rregullat në fuqi lidhur me raportimin financiar të subjekteve politike;
- Nëse deklaratat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtet financiare për burimet dhe shpenzimet gjatë periudhës së fushatës zgjedhore;
- Nëse kontributet janë pranuar në pajtim me Ligjin 2004/2;
- Nëse shpenzimet janë raportuar sipas degëve dhe komunave;
- Nëse shpenzimet e raportuara nuk tejkalojnë limitet e parapara sipas komunave dhe i takojnë periudhës raportuese;
- Konstatimi i Subjekteve politike që kanë fituar vende;
- Verifikimi i informatave nga DF te personat e tretë (Administrata Tatimore, Zyra Kadastrale , Zyra për regjistrimin e Bizneseve, Bankat etj);
- Përgatitja e Raporteve paraprake dhe Raportit përfundimtar në formën dhe afatet e parapara
- Shqyrtimi dhe përpunimi i Raporteve Korrigjuese të Subjekteve Politike;

<sup>12</sup>Për auditimin e subjekteve politike për zgjedhjet lokale te vitit 2009 , përgjegjëse ishte kompania audituese Ligjore "Univerzum Audit", e cila ka bere një auditim në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ( kontrata 320/10/060/211, data 02.09.2010).

Ndërsa, për të kuptuar më tepër gatishmërinë e subjekteve politike për të dorëzuar raportet e tyre financiare për zgjedhjet lokale të vitit 2009, shihni tabelën më poshtë :

Numri i subjekteve politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje	Subjektet politike që kanë dorëzuar Deklaratën Financiare në KQZ	Subjektet politike që nuk e kanë dorëzuar Deklaratën Financiare në KQZ	Raundi i zgjedhjeve
79 subjekte politike	58 subjekte politike	21 subjekte politike	I
8 subjekte politike (SNSD, Rufki Suma, SLS, PDK, LDD, AKR, AAK, LDD)	6 subjekte politike (SNSD, Rufki Suma, SLS, PDK, LDD, AKR, dhe LDD)	2 subjekte politike (AAK, LDK)	II
2 subjekte politike (LDK, PDK)	1 subjekt politik (LDK)	1 subjekt politik (PDK)	Përsëritja e raundit të II në komunitet e Prizrenit, Lipjanit, dhe Gjilanit
2 subjekte politike (LDK, PDK)	1 subjekt politik (LDK)	1 subjekt politik (PDK)	Në zgjedhjet jashtëzakonshme komuna e Istogut-raundi I

**Tabela 2.** Situata e raportimit të deklaratave financiare nga subjektet politike në KQZ për zgjedhjet komunale 2009.



## LËSHIMET MË TË SHPESHTA TË SUBJEKTEVE POLITIKE GJATË VITIT 2009 SIPAS RAPORTIT TË AUDITIMIT

Siç edhe vërehet nga tabela e prezantuar më lartë, subjektet politike nuk i kanë dorëzuar Deklaratat Financiare në afatin e rregullt kohor dhe për secilin raund të zgjedhjeve, duke veçuar këtu subjektet me të mëdha politike. Në këtë raport vërehet se shumica e subjekteve politike edhe pse kanë dorëzuar Deklaratat Financiare në KQZ, ato i kanë dorëzuar me shënime gjysmake apo të pasakta. Për disa nga shpenzimet e bëra subjektet politike nuk kanë mundur të sigurojnë as dokumentet e nevojshme për të dëshmuar nëse ato shpenzime kanë qenë reale, në krahasim me atë që është paraqitur.

Fakti tjetër mjaft i ndjeshëm dhe serioz është se subjektet politike në vazhdimësi kanë hezitur të publikojnë origjinën e mjeteve të dhëna si donacion nga personat privat dhe juridik. Në anën tjetër, për origjinat që i kanë deklaruar, nuk iu kanë bashkangjitur dokumentet burimore të cilat kërkohen edhe me ligj, ku përfshihen gjendja e llogarisë bankare apo dëftesat e transaksioneve të kryera. Mungesa e zyrtarëve për financa, ndërrimi i shpeshtë i tyre, apo edhe përgatitja e pamjaftueshme profesionale për tu marrë me punë financiare janë mangësi dhe elemente tjera të realitetit me të cilat subjektet politike karakterizohen.

Për më tepër, një element tjetër që ka karakterizuar gati se të gjitha subjektet politike është edhe mosdeklarimi apo nënvlerësimi i shpenzimeve të bëra për aktivitete të ndryshme, siç janë: përdorimi i veturave me qira, derivatet, videoklipet televizive, radiot, dhe billbordat, qiratë për zyre, pagat për shërbime të ndryshme, dhe vëzhguesit. Ndërsa, një element tjetër e që është mjaftë i rëndësishëm dhe që mund të ndihmojë në zbulimin e burimeve të financimit të subjekteve politike është prezantimi i gjendjes së llogarisë bankare, gjë që i është mohuar audituesit që të këtë qasje.

Rekomandimet konkrete të dhëna në Raportin e Auditimit për vitin 2009<sup>13</sup>, duhet tu ndihmojnë subjekteve politike, dhe duhet të jenë një udhërrëfyes që subjektet politike ti evitojnë lëshimet dhe gabimet e bëra paraprakisht.

<sup>13</sup> Raporti i Auditimi 2009 <http://ëëë.kqz-ks.org/SKQZ-ËEB/al/materiale/raportiauditimit2009.pdf>

## SJELLJET E SUBJEKTEVE POLITIKE NË RAPORT ME TRANSPARENÇËN E FINANCIMIT TË TYRE GJATË FUSHATËS PARAZGJEDHORE 2010

Për të bërë një raport më të saktë në lidhje me dorëzimin e Deklaratave Financiare nga subjektet politike, KDI vazhdimisht ka komunikuar me subjektet kryesore të monitoruara gjatë kësaj fushate. Në bazë të informatave të nxjerra nga subjektet politike del se shumica e subjekteve politike i kanë dorëzuar raportet e tyre në KQZ në afatet e përcaktuara me ligj. Përrjashtim ka bërë vetëm subjekti politik PDK, nga i cili nuk ka qenë e mundur të merren informata për këtë çështje, siç kanë kumtuar, për arsye të mungesës së një zyrtari të caktuar financiar.

Në anën tjetër, për të vërtetuar nëse subjektet iu kanë përmbajtur ligjit mbi financimin e tyre, përkatësisht për të parë më afër nëse këto raporte janë dorëzuar me të vërtetë nga subjektet e monitoruara në këtë hulumtim, KDI që nga muaji janar i këtij viti e deri më tani ka bërë kërkesa të njëpasnjëshme në KQZ për të pasur qasje në Deklaratat Financiare të subjekteve politike. Duhet theksuar se, edhe pse me ligjin mbi zgjedhjet e përgjithshme dhe ligjin mbi financimin e subjekteve politike KQZ është e obliguar që të krijoj një dosje të Deklaratave Financiare të dorëzuara nga subjektet politike dhe që do të ishte qasshme për publikun, KQZ nuk e ka ndërmarrë një veprim të tillë. Të mos përmendet këtu detyrimi ligjor i KQZ-së që të bëjë transparente këto Deklarata Financiare në uebfaqen zyrtare të saj, e cila po ashtu nuk është zbatuar fare.

Të gjitha kërkesat e KDI-së që i janë bërë KQZ-së për t'iu qasur Deklaratave Financiare të vitit 2010, kanë mbetur të heshtura dhe të pa miratuara nga KQZ-ja deri në momentet e fundit apo me saktësisht deri me 22 mars, 2011. Situata e tillë është analizuar me kujdes, dhe kemi ardhur në përfundim se është vakuumi ligjor ai i cili i mundëson KQZ-së për të shtyrë afatin e publikimit të Deklaratave Financiare. Kjo, pasi që ligji nuk e specifikon afatin kohor se kur KQZ duhet të publikoj këto Deklarata Financiare, si dhe nuk specifikon nëse ato duhet të publikohen në uebfaqen zyrtare të KQZ-së para apo pas realizimit të auditimit.

Bazuar, në të gjeturat e KDI-së, shkeljet më të mëdha që subjektet politike kanë bërë gjatë fushatës për vitin 2010 janë : nënvlersimi i shpenzimeve , mos deklarimi i pasurive, deklarimi gjysmak i te hyrave dhe shpenzimeve totale, apo edhe mos deklarimi fare i këtyre të fundit, mos paraqitja e donatorëve privat, mungesat e dëshmimeve për të vërtetuar shpenzimet, mungesa e dokumentacionit që tregon gjendjen e gjirologarise bankare, dorëzimi i deklaratave financiare pas mbarimit të afatit të paraparë me ligj, si dhe tejkalimi i limitit të shpenzimeve të lejuara me ligj. Vlenë të përmendet se këto lëshime ishin bërë nga subjektet politike edhe përgjate fushatës së zgjedhjeve lokale të vitit 2009, ku megjithëse auditori kishte dhënë rekomandime konkrete për ti evituar këto , subjektet politike vazhdojnë të sillen në mënyrën e njëjt, duke i bërë këto të papërgjegjshmedhe dhe adresë për kritika të vazhdueshme nga ana e organizatave të shoqërisë civile.

## II. REZULTATE DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

### A. Metodologjia e hulumtimit

Për të monitoruar shpenzimet e subjekteve politike KDI ka angazhuar një staf prej 60 personave të cilët kanë monitoruar fushatën parazgjedhore në 34 komuna të Republikës së Kosovës, me nga së paku një vëzhgues përgjegjës për secilën komunë. Të gjitha komunat janë riorganizuar në 9 regjione, me nga një koordinator përgjegjës. Objekt monitorimi në këto komuna ishin aktivitetet parazgjedhore të subjekteve politike si në vijim:

- PDK, LDK, AKR, LDD, AAK<sup>15</sup>
- KDTP, SLS<sup>16</sup>
- Vetëvendosje, FER<sup>17</sup>.

Vëzhguesit morën pjesë në aktivitetet e këtyre subjekteve në komunat përkatëse, ku vrojtuan shpenzimet, të cilat i regjistronin në formularë, dhe më pas i dorëzonin tek koordinatorët dhe personat gjegjës për t'i futur këto në bazën e të dhënave. Bashkë me këta formularë vëzhguesit kanë dorëzuar edhe fotografi të ndryshme të ngjarjeve të organizuara nga subjektet politike.

Në formularë janë identifikuar artikujt dhe sasia e shpenzuar nga subjektet politike për aktivitete, si dhe materialet tjera promovuese të përdorura e shpenzuara jashtë këtyre aktiviteteve apo artikujt me jetëgjatësi me te madhe siç janë: reklamat në rrugë, posterë, billborde, etj. Nga vëzhguesit gjithashtu është kërkuar të identifikojnë nëse është bërë keqpërdorimi i pronës publike, si për shembull nëse është bërë përdorimi automjeteve zyrtare, dhe nëse janë përfshirë shërbyesit civil gjatë orarit të rregullt të punës<sup>18</sup> apo edhe fëmijët kanë marrë pjesë në fushatë.

KDI gjithashtu ka bërë monitorimin e fushatës së subjekteve politike, promovimit të tyre, në të gjitha gazetatat ditore dhe në ueb portalet më të njohura në shtet. Ndërsa, përcaktimi i çmimit është bërë në bazë të ofertave që janë siguruar nga gazetatat dhe ueb portalet.

Për kalkulimin e shpenzimeve të subjekteve politike, për reklama gjatë fushatës parazgjedhore në TV dhe radio, janë shfrytëzuar informatat e dhëna nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe nga vet mediumet. Po ashtu, në këto kalkulime nuk janë përfshirë zbritjet e mundshme të çmimeve, të cilat kanë mundur ti ofrojnë kompanitë e ndryshme. Ndërsa, në këtë monitorim nuk janë përfshirë shpenzimet përgatitjes së video-spotëve televizive, audio-spotëve në radio, materialeve të shtypura, si dhe shpenzimet e kompanive të kontraktuara për dizajnimin dhe menaxhimin e fushatës, të cilat mund ta rrisin edhe më tej koston totale të fushatës.

<sup>14</sup> Në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe në veriun e Mitrovicës, nuk kemi mundur të gjejmë bashkëpunëtorë.

<sup>15</sup> Subjektet politike të cilat patën kaluar pragun zgjedhor prej 5 % dhe janë përfaqësuar në mandatin e fundit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

<sup>16</sup> Subjektet politike që përfaqësojnë pakicat kombëtare në parlament

<sup>17</sup> Subjektet politike që sapo janë regjistruar


<sup>18</sup> Ju lutem gjeni Formularin e bashkangjitur në Shtojcën e këtij dokumenti.

## B. Rezultate të përgjithshme

Në bazë të monitorimit të këtij procesi kemi arritur në përfundim se gjithsejtë shpenzimet e subjekteve politike për aktivitete<sup>19</sup>, reklama në shtypin ditor, reklama në ueb portale, reklama në TV, dhe reklama në radio janë 3,062,912 Euro . Tabela dhe Grafi në vazhdim japin një pasqyrë më të hollësishme të këtyre shpenzimeve. Me 32.81 % PDK prin e para në shpenzimet e përgjithshme, kurse LDK me 19.85 % del e dyta. E fundit është SLS me 1.65 %.

	Subjekti	Vlera në Euro	Përqindja
1	PDK	1,004,814	32.81
2	LDK	608,037	19.85
3	AKR	553,738	18.08
4	AAK	459,521	15
5	LDD	140,186	4.58
6	VV	105,017	3.43
7	KDTP	74,431	2.43
8	FER	66,507	2.17
9	SLS	50,661	1.65
	<b>Shuma</b>	<b>3,062,912</b>	<b>100</b>

Tabela 3. Shpenzimet e përgjithshme të subjekteve politike.



Grafi 1. Renditja e subjekteve politike sipas shpenzimeve të përgjithshme gjatë fushatës.

<sup>19</sup> Këtu hyjnë edhe reklamato në rrugë, si billboardat dhe posterët e ndryshëm.

<sup>20</sup> Vërejtje: Këtu nuk përfshihen shpenzimet për paga dhe telefon për organizatorët e aktiviteteve të kontraktuar nga subjektet politike.

Ndërkaq, në tabelën më poshtë mund të shihni dallimin në mes të shumës sa kanë marrë subjektet nga Fondi dhe sa ato kanë shpenzuar gjatë fushatës.

	Subjekti	Vlera e shpenzuar	Vlera e marrë nga Fondi shtetëror	Ndryshimi
1	PDK	1,004,814	174,270	830,544
2	LDK	608,037	117,750	490,287
3	AKR	553,738	61,230	492,508
4	AAK	459,521	61,230	398,291
5	LDD	140,186	51,810	88,376
6	VV	105,017	6,000 <sup>21</sup>	99,017
7	KDTP	74,431	32,970	41,461
8	FER	66,507	6,000 <sup>22</sup>	60,507
9	SLS	50,661	37,680	12,981
	<b>Shuma</b>	<b>3,062,912</b>	<b>548,940</b>	<b>2,513,972</b>

**Tabela 4.** Ndryshimi në mes të shpenzimeve dhe shumave të ndara nga Fondi.

Me fjalë tjera, ndryshimi paraqet shumën e shpenzimeve të shprehura në Euro që subjektet politike është dashur ta gjejnë nga donatorë të ndryshëm për të mbuluar shpenzimet e tyre përgjatë fushatës.

### C. Shpenzimet e subjekteve politike të deklaruara në KQZ deri më 22 mars 2011

Në tabelën e prezantuar më poshtë shihet se shumë prej subjekteve politike nuk i kanë dorëzuar të gjitha shpenzimet e tyre sikurse kërkohet me dispozitat ligjore. Vërejmë se shkelje të ndryshme kanë bërë subjektet si: PDK, e cila i ka dorëzuar vetëm shpenzimet dhe donacionet e pranuar për 7 komuna, ndërsa SLS i ka dorëzuar dhe i ka tërhequr prapë dokumentet e dorëzuara në KQZ, ndonëse kanë kaluar afatet kohore për të dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Gjithashtu, një element që ka qenë mjaftë i shprehur tek subjektet politike janë rastet e deklarimit të shpenzimeve pa detaje të donacioneve të cilat i kanë pranuar nga donatorë të ndryshëm, e ku hyjnë LDK-ja, AAK-ja, dhe AKR-ja.

Në anën tjetër, subjektet e vetme politike që kanë të dorëzuara informatat për dy elementet e kërkuara: shpenzimet dhe donacionet janë VV, FER, dhe LDD. Për më tepër, shumat e deklaruara në KQZ nuk përkojnë me shumat të cilat KDI ka arritur ti sigurojë gjatë monitorimit të shpenzimeve të fushatës parazgjedhore 2010, gjë që vë në dyshim shumicën e deklaratave financiare të subjekteve politike të dorëzuara në KQZ.

<sup>21</sup> Shumë përafërsisht e njëjtë


<sup>22</sup> Shumë përafërsisht e njëjtë

Për më tepër shih tabelën më poshtë:

Nr	Subjekti	Shpenzimet e deklaruar	Donacionet e deklaruar	Vërejtje
1	<b>PDK</b>	145,984	117,501	Të deklaruar vetëm për 7 / nga 37 komuna në Republikën e Kosovës
2	<b>LDK</b>	296,751	Nuk ka paraqitur shummat e pranuar nga donatorët.	
3	<b>AAK</b>	176,885	Nuk ka paraqitur shummat e pranuar nga donatorët.	
4	<b>AKR</b>	401,834	Nuk ka paraqitur shummat e pranuar nga donatorët.	
5	<b>VV</b>	91,425	96,505	
6	<b>FER</b>	75,006	19,485	
7	<b>LDD</b>	6,540	6,500	
8	<b>KDTP</b>	32,080	6,700	
9	<b>SLS</b>	Janë dorëzuar njëherë, por janë tërhequr dokumentet prapë për plotësime të mëtutjeshme!	Janë dorëzuar njëherë, por janë tërhequr dokumentet prapë për plotësime të mëtutjeshme!	Janë dorëzuar njëherë, por janë tërhequr dokumentet prapë për plotësime të mëtutjeshme!
	<b>Shuma totale</b>	<b>1226505</b>	<b>246691</b>	

**Tabela 5.** Shpenzimet dhe donacionet e deklaruar nga subjektet politike deri më 22 mars 2011.






Grafi 2. Shpenzimet e deklaruar nga subjektet politike deri më 22 mars 2011.

### Ç. Shpenzimet për aktivitete: takimet me qytetarë dhe reklamat në rrugë

Për aktivitete, takime me qytetarë dhe reklama në rrugë, kemi kalkuluar që subjektet politike kanë shpenzuar 2,249,276 Euro. Nga tabela dhe grafi në vazhdim mund të kuptojmë që renditja e subjekteve politike është e njëjtë me atë të shpenzimeve të përgjithshme, ku PDK prin me 708,492 Euro ose 31.50 %, dhe në fund të listës gjendet FER me 31,744 Euro ose 1.41 %. Dallimi në mes të subjektit që ka shpenzuar më së shumti PDK-së dhe subjektit që ka shpenzuar i dyti LDK-së është 12.12 %.

	Subjekti	Vlera në Euro	Përqindja
1	PDK	708,492	31.5
2	LDK	435,837	19.38
3	AKR	377,845	16.8
4	AAK	363,100	16.14
5	LDD	115,876	5.15
6	VV	94,840	4.22
7	KDTP	70,881	3.15
8	SLS	50,661	2.25
9	FER	31,744	1.41
	<b>Shuma</b>	<b>2,249,276</b>	<b>100</b>

Tabela 6. Shpenzimet për aktivitete të subjekteve politike.




Grafi 3. Renditja e subjekteve politike sipas shpenzimeve për aktivitete.

### 1. Shpenzimet në ditë për aktivitete

Dita	Data	Vlera në Euro	Përqindja
E mërkure	1 dhjetor 2010	130,900.65	5.82
E enjte	2 dhjetor 2010	161,428.36	7.18
E premte	3 dhjetor 2010	178,293.03	7.93
E shtunë	4 dhjetor 2010	200,179.48	8.9
E diel	5 dhjetor 2010	198,731.22	8.84
E hënë	6 dhjetor 2010	160,877.95	7.15
E martë	7 dhjetor 2010	284,360.73	12.64
E mërkure	8 dhjetor 2010	287,462.88	12.78
E enjte	9 dhjetor 2010	200,891.25	8.93
E premte	10 dhjetor 2010	446,150.04	19.84
	<b>Shuma</b>	<b>2,249,275.58</b>	<b>100</b>

Tabela 7. Shpenzimet e subjekteve politike për aktivitete për çdo ditë të fushatës



**Grafi 4.** Shpenzimet e subjekteve politike për çdo ditë të fushatës.


Nga tabela dhe grafi më lartë kuptojmë që shumica e subjekteve politike kanë shpenzuar më pak në fillim të fushatës, me tendencë të shpenzojnë më shumë kah fundi i fushatës, domethënë kah afrimi i ditës së zgjedhjeve. Këtu vërehet që shumica e subjekteve politike kanë shpenzuar rreth 20 % të shpenzimeve të përgjithshme në ditën e fundit të fushatës. Kjo mund të arsyetohet me atë që subjektet politike kanë zgjedhur ta përkujtojnë elektoratin e tyre sa më afër ditës së Zgjedhjeve.

## 2. Shpenzimet për komunë

Sipas hulumtimit rezultatet e të cilit i kemi prezantuar në tabelën dhe grafikun më poshtë, vërejmë se në Prishtinë dhe Prizren subjektet kanë shpenzuar 445,760.40 Euro ose 19.82 % dhe 387,084.36 Euro ose 17.21 % respektivisht: në të dyja bashkë kanë shpenzuar 37.03 % nga gjithsejtë shpenzimet e vrojtura. Në të gjitha komunat tjera shpenzimet janë me përqindje me vlerë njëshifrore, ku prijnë shpenzimet e vrojtura në Gjakovë (7.75 %), Pejë (6.09 %), Gjilan (6.03 %), Podujevë (3.79 %), Mitrovicë (3.68 %). Gjithashtu vërejmë se në komunat veriore të Zveçanit, Leposaviqit e Zubin Potokut, si dhe në komunat e reja të Kllokotit dhe Mamushës nuk janë vërejtur të ketë shpenzime për fushatë nga subjektet politike të përfshira në hulumtim.

	Komuna	Vlera	Përqindja
1	Deçan	53,903.68	2.4
2	Dragash	15,679.96	0.7
3	Drenas	33,141.69	1.47
4	Ferizaj	52,911.18	2.35
5	Fushë Kosovë	38,530.94	1.71
6	Gjakovë	174,237.61	7.75
7	Gjilan	135,561.26	6.03
8	Graçanicë	15,028.00	0.67
9	Hani i Elezit	7,729.04	0.34
10	Istog	78,262.87	3.48
11	Junik	6,963.43	0.31
12	Kaçanik	19,716.08	0.88
13	Kamenicë	57,050.20	2.54
14	Klinë	33,602.57	1.49
15	Klllokot	0	0
16	Leposaviq	0	0
17	Lipjan	80,990.93	3.6
18	Malishevë	30,261.73	1.35
19	Mamushë	0	0
20	Mitrovicë	82,811.55	3.68
21	Novobërdë	3,975.62	0.18
22	Obiliq	15,857.54	0.71
23	Partesh	2,847.19	0.13
24	Pejë	137,052.75	6.09
25	Podujevë	85,199.84	3.79
26	Prishtinë	445,760.40	19.82
27	Prizren	387,084.36	17.21
28	Rahovec	34,078.78	1.52
29	Ranillug	3,168.49	0.14
30	Shtërpce	27,091.67	1.2
31	Shtime	52,937.56	2.35
32	Skenderaj	32,169.48	1.43
33	Suharekë	31,586.98	1.4
34	Viti	27,688.43	1.23
35	Vushtrri	45,821.25	2.04
36	Zubin Potok	572.6	0.03
37	Zveçan	0	0
	<b>Shuma</b>	<b>2,249,275.58</b>	<b>100</b>

Tabela 8. Shpenzimet e subjekteve për secilën komunë.



Grafi 5. Shpenzimet e subjekteve për komunë.

#### D. Shpenzimet në shtypin ditor

Në hulumtim janë përfshirë reklamat e subjekteve politike, duke përfshirë këtu edhe ato të kandidatëve të tyre, në gazeta të ndryshme. Gazetat që janë përfshirë në këtë hulumtim janë Koha Ditore, Zëri, Bota Sot, Epoka e Re, Lajmi, Kosova Sot, Gazeta Express, Tribuna, dhe Info Press. Reklamat që janë kalkuluar kanë qenë të formateve të ndryshme, ndërsa çmimet e reklamave janë marrë nga ofertat që i janë siguruar KDI-së prej secilës gazetë të lartpërmendur.


##### 1. Shpenzimet sipas subjektit politik

Subjektet politike vetëm në shtypin ditor kanë shpenzuar gjithsejtë 257,553 Euro. Këtu prin PDK me 122,005 Euro ose 47.37 % të shpenzimeve të përgjithshme, përcjell nga : AKR si e dyta, LDK e treta, ndërkaq ,KDTP dhe SLS radhiten në fund me më pak shpenzime. Duke qenë se nuk kemi monitoruar asnjë gazetë serbe, apo turke mund të themi që informatat e dhëna për këto subjekte politike janë të sakta vetëm për gazetatat e përfshira, por jo për shpenzimet e përgjithshme të këtyre subjekteve të bëra për reklamimet në gazeta.

Tabela 8 dhe Grafi 5 shpjegojnë në hollësi shpenzimet e subjekteve për këtë qëllim, duke u renditur nga subjekti që ka shpenzuar më së shumti deri tek ai që ka shpenzuar më pak.

	Subjekti	Vlera në Euro	Përqindja
1	PDK	122,005	47.37
2	AKR	75,639	29.37
3	LDK	36,614	14.22
4	AAK	10,224	3.97
5	FER	6,603	2.56
6	LDD	3,194	1.24
7	VV	1,824	0.71
8	KDTP	1,450	0.56
9	SLS	0	0
	<b>Shuma</b>	<b>257,553</b>	<b>100</b>

Tabela 9. Shpenzimet për shtypin ditor.



Grafi 6. Renditja e subjekteve sipas shpenzimeve për fushatë në shtypin ditor.




## 2. Sipas gazetës

22

Gazetat që kanë pasur më së shumti reklama të subjekteve politike janë: Zëri, Epoka e Re, Koha Ditore, Bota Sot, Gazeta Express, Info Press, Lajm, Kosova sot dhe Tribuna. Tabela 9 dhe Grafi 6 tregojnë shpenzimet nëpër këto gazeta të shprehura në vlera dhe përqindje.

	Shtypi ditor	Vlera në Euro	Përqindja
1	Zëri	49,005	19.03
2	Epoka e Re	43,049	16.71
3	Koha Ditore	35,386	13.74
4	Bota Sot	28,467	11.05
5	Gazeta Express	26,842	10.42
6	Info Press	25,052	9.73
7	Lajmi	20,184	7.84
8	Kosova Sot	17,758	6.89
9	Tribuna	11,810	4.59
<b>Shuma</b>		<b>257,553</b>	<b>100</b>

Tabela 10. Shpenzimet për reklama të subjekteve në shtypin ditor.



Grafi 7. Rendiça e gazetave sipas shpenzimeve për reklama të subjekteve politike.

### 3. Sipas subjektit dhe gazetës

Ndërkaq, tre subjektet që kanë shpenzuar më së shumti për reklamim në shtypin ditor, kanë bërë zgjedhjet dhe shpenzimet e mëposhtme:

PDK ka shpenzuar për reklama në gazetat si në vijim:

1	Epoka e Re	24.53%
2	Express	14.26%
3	Zëri	12.13%
4	Lajmi	9.94%
5	Info Press	9.89%
6	Kosova Sot	9.32%
7	Koha Ditore	7.93%
8	Bota Sot	6.56%
9	Tribuna	5.45%

AKR ka shpenzuar për reklama në gazetat si në vijim:

1	Bota Sot	19.22%
2	Zëri	17.33%
3	Epoka e Re	15.99%
4	Info Press	14.64%
5	Koha Ditore	12.48%
6	Express	7.84%
7	Lajmi	7.21%
8	Tribuna	5.29%
9	Kosova Sot	0.00%

Dhe LDK ka shpenzuar për reklama në gazetat si në vijim:

1	Zëri	42.21%
2	Koha Ditore	34.15%
3	Kosova Sot	6.02%
4	Bota Sot	5.05%
5	Info Press	3.96%
6	Lajmi	3.96%
7	Epoka e Re	2.49%
8	Tribuna	2.16%
9	Express	0.00%

## Dh. Shpenzimet në ueb portale

Në hulumtim janë përfshirë reklamat e subjekteve politike në ueb portale, duke përfshirë këtu edhe ato të kandidatëve të tyre. Ueb portalet që janë përfshirë në këtë hulumtim janë: Telegrafi, Indeks Online, Bota Sot Online, Kosova Info, Express Online dhe Zëri Info. Reklamat që janë kalkuluar, kanë qenë të formateve të ndryshme dhe të vendosura në pozicione ndryshme në ueb portale. Çmimet e reklamave janë marrë nga ofertat e siguruar nga KDI prej secilit portal të lartpërmendur. Vlen të përmendet se kalkulimi i shpenzimeve në ueb portale ka qenë i vështirë: duke marrë parasysh që disa ueb portale kanë ndryshuar reklamat brenda këtyre dhjetë ditëve, ka pamundësuar kalkulimin e saktë të shpenzimeve për këtë kategori të shpenzimeve.

### 1. Shpenzimet në ueb portale sipas subjektit politik


Shuma totale për 10 ditë është 29,224 Euro të shpenzuara nga të gjitha subjektet politike për reklamat e tyre në portalet e lartpërmendura. Sikurse është vërejtur edhe më parë, edhe për këtë kategori subjekti në pushtet PDK prin me 11,700 Euro ose 40.04 % të shpenzimeve të përgjithshme, dhe pas saj renditen LDK me 5,200 Euro ose 17.79 %, AAK me 4,700 Euro ose 16.08 %, ndërkaq LDD, KDTP e SLS renditen të fundi<sup>23</sup>.

Tabela dhe trafikoni më poshtë shpjegojnë në hollësi shpenzimet e subjekteve për fushatë në ueb portale, duke u renditur nga subjekti që ka shpenzuar më së shumti deri tek ai që ka shpenzuar më së paku.

	Subjekti	Vlera në Euro	Përqindja
1	PDK	11,700	40.04
2	LDK	5,200	17.79
3	AAK	4,700	16.08
4	AKR	3,224	11.03
5	FER	3,200	10.95
6	VV	1,200	4.11
7	LDD	0	0
8	KDTP	0	0
9	SLS	0	0
	<b>Shuma</b>	<b>29,224</b>	<b>100</b>

Tabela 11. Shpenzimet e subjekteve politike për reklamat në ueb portale.

<sup>23</sup>Vërejtje: Ky rezultat mund të jetë si pasojë e mos monitorimit të ndonjë ueb portali në gjuhën serbe apo turke, për komunitet përkatëse.




Grafi 8. Renditja e subjekteve sipas shpenzimeve për fushatë në ueb portale.

## 2. Sipas ueb portalit

Ueb portalet që kanë pasur më së shumti reklama të subjekteve politike janë: Indeks Online, Telegrafi, Bota Sot Online, Kosova.info, Express Online dhe Zeri.info. Për më shumë hollësi ju lutem shikoni tabelën dhe grafikun në vazhdim.

	Ueb Portalet	Vlera në Euro	Përqindja
1	Indeks Online	16,700	50
2	Telegrafi	9,024	31.37
3	Bota Sot Online	2,300	12.23
